



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2023/1028**  
**Data e Vendimit: 26.12.2023**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Limit L & B SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi i rrugëve të Komunës së Fushë Kosovës” me numër të prokurimit 612-23-11679-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me 26/12/2023, mori këtë:

### **Vendim**

1. Hedhet si e palejuar, ankesa e OE Limit L & B SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/1028, e datës 18/12/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi i rrugëve të Komunës së Fushë Kosovës”, me numër të prokurimit 612-23-11679-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË.
2. I lejohet, autoritetit kontraktues – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi i rrugëve të Komunës së Fushë Kosovës”, me numër të prokurimit 612-23-11679-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.
3. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

### *-Faktet dhe rrethanat procedurale-*

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 18.12.2023 ka pranuar ankesën me nr.1028/23 nga OE ankues Limit L & B SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi i rrugëve të Komunës së Fushë Kosovës”, me numër të prokurimit 612-23-11679-5-2-1, inicuar nga Kuvendi Komunal Fushë Kosovë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

Kuvendi i Komunës Kaçanik me datën 25.10.2023 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë ndërsa me datën 29.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit e përshkruar si me sipër.

OE ankues Limit L & B SH.P.K. me datën 05.12.2023 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim ndaj vendimit të lartcekur, rrjedhimisht me datën 07.12.2023 AK - Kuvendi Komunal Fushë Kosovë ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave -*

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi i rrugëve të Komunës së Fushë Kosovës”, me numër të prokurimit 612-23-11679-5-2-1, inicuar nga Kuvendi Komunal Fushë Kosovë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datën 25.12.2023 ka publikuar B05 Njoftimin për kontratë ndërsa me datën 29.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

OE ankues Limit L & B SH.P.K. me datën 05.12.2023 ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim ndaj vendimit të lartcekur, rrjedhimisht me datën 07.12.2023 AK - Kuvendi Komunal Fushë Kosovë ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Zyra për pranimin e ankesave, pas pranimin të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi kërkesën për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues e ka paraqitur jashtë afateve ligjore.

Neni 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.*

Po ashtu, edhe neni 60.1 pika b) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit*

*të AK (B58) është dita (0).*

Konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 18.12.2023 nga OE Limit L & B SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi i rrugëve të Komunës së Fushë Kosovës”, me numër të prokurimit 612-23-11679-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën përrishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues B58. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së.

Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal Fushë Kosovë mund që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Sinjalizimi i rrugëve të Komunës së Fushë Kosovës”, me numër të prokurimit 612-23-11679-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Megjithatë OSHP i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK ,duhet të veprojnë konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 24.2, 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

### **Vendimi t'i dorëzohet:**

- **AK - KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**
- **OE - . Limit L & B SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: